

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. Prot.

Vlorë, më 29.01.2018

Vendim
Nr. 1, datë 29.01.2018

PËR


“PËR NGARKESËN MËSIMORE NE AUDITOR TË PERSONELIT AKADEMIK”

Bazuar në pikën 8 të nenit 59, të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Udhëzimi nr. 20, datë 09.05.2008 i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, Rektorati në mbledhjen e datës 29.01.2018

VENDOSI:

1. Për nevoja të institucionit, personeli akademik i Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, përfshirë dhe autoritetet drejtuese akademike, pasi të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e kohës vjetore të punës, 1536 orë, mund të tejkalojë deri në 260 orë mësimore, normën vjetore të mësimdhënies në auditor, shprehur në orë mësimore të konvertuara, sipas pikës 4.2.1 dhe 4.2.2 të Udhëzimit të MASR, nr. 20, datë 09.05.2008, "Për veprimtarinë e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të lartë".
2. Ky vendim ti percillet për miratim Senatit Akademik.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. Prot.

Vlorë, më 21.02.2018

Vendim
Nr.2 , datë 21.02.2018

PËR
AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TE STUDIMIT

Në mbështetje të nenit 40, në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM nr 109, datë 15.02.2017, " Për riorganizimin e agjensisë publike te arsimit te larë APAAL, në angjensinë e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë ASCAL", në Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2017 " Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga IAL-të, Rektorati në mbledhjen e datës 21.02.2018,

VENDOSI:

1. T'i përcjellë Administratorit, kërkesën që në Buxhetin e vitit 2018, të parashikojë mbështetjen financiare në funksion të paraqitjes në ASCAL të kërkesës për akreditimin e të gjitha programeve të studimit të riorganizuara.
2. Riorganizimi i programeve të studimit, të përfundoj brenda datës 30.05.2018.
3. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Dekanët, Shefat e Departamenteve, Asambleja e Personelit Akademik, Dega Mësimore Administratori si dhe Drejtoria e Finacës dhe Realizimit te Buxhetit.
4. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 913/1 Prot.

Vlorë, më 17.07.2018

VENDIM

Nr. 03 datë 17.07.2018

PËR
DIPLOMIMIN E STUDENTEVE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE
MASTER I SHKENCAVE PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018

Në mbështetje të ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit Nr. 52 datë 03.12.2015 i ndryshuar " Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë,


VENDOSI:

1. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, do të futen në provimin e diplomimit/mbrojtje teze vetëm pas plotësimit të kriterëve të mëposhtëme:
 - Të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare .
 - Të dorëzojnë pranë sekretarive përkatëse dëshmin e njohjes së gjuhëve të huaja sipas nivelit të përcaktuar.
2. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori akademik, Drejtoria e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve, Drejtuesit e Njësive Kryesore, Drejtuesit e Njësive Bazë si dhe të gjitha sekretarit mësimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Dr. Roland ZISI

REKTOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 1123/11 Prot.

Vlorë, më 27. 09.2018

VENDIM

Nr. 4 , datë 13. 09.2018

PËR MODELIN E RREGJITRAVE TE KURSIT VITIN AKADEMIK 2018 - 2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Rektorati në mbledhjen e datës 13.09.2018


VENDOSI:

1. Të miratojë formatin dhe përdorimin prej personelit akademik të rregjistrave të kursit.
2. Të miratojë formatin dhe përdorimin prej personelit akademik të Fakultetit të Shëndetit Publik përveç rregjistrave të kursit dhe rregjistrave grupi për praktikantët mesimorë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Dekanët, Përgjegjës të Departamenteve si dhe gjithë personeli akademik i universitetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 1123/2 Prot.

Vlorë, më 27. 9.2018

VENDIM

Nr. 5 , datë 13. 9.2018

FILLIMIN E RREGJISTRIMEVE NE CIKLIN E STUDIMEVE MASTER PËR
VITIN AKADEMIK 2018 - 2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit Nr. 26, datë 30.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Rektorati në mbledhjen e datës 13.09.2018


VENDOSI:

1. Të miratojë periudhën 14.09.2018-12.10.2018 si periudhë rregjistrimesh për ciklin e dytë të studimeve.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Dekanët, Përgjegjësat e Departamenteve si dhe sekretarite mësimore të cdo fakulteti.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 1123/B Prot.

Vlorë, më 27.09.2018

VENDIM

Nr. 6, datë 13.09.2018

"PËR PROCEDURA E HARTIMIT, FORMATIMIT DHE EMETIMIT ZYRTAR TE PROCESVERBALIT TE PROVIMIT TË PJESËSHËM DHE PËRFUNDIMTAR"

Në mbështetje të nenit 101 të Ligjit 80/2015, të nenit x të Ligjit "Për Arkivat në RSH" si dhe për një disiplinim më të mirë të të dhënave (RHK) të dokumentacionit të procesit mësimor dhe emetimit të tyre në Softwerin e informimit të studentëve, Rektorati, në mbledhjen e datës, 13. 09. 2018,

VENDOSI:

PROCEDURA E HARTIMIT, FORMATIMIT DHE EMETIMIT ZYRTAR TE PROCESVERBALIT TE PROVIMIT TË PJESËSHËM DHE PËRFUNDIMTAR TË JETË SI MË POSHTË:

1. Në fillim të vitit akademik, Sekretaritë Mësimore u dorëzojnë pedagogëve që zhvillojnë modulet e programeve të studimit, listën e azhornuar të studenteve, të firmosura prej tyre, nga kryesekretaria dhe nga Dekani.
2. Pedagogu i modulit, ditën e fundit të javës së fundit të procesit mësimor, dorëzon me shkrim, në sekretarinë mesimore të departamentit, elementet e performances akademike të çdo studenti, sipas kërkesave të Rregullores së Brendshme të UV-së dhe Rregullores së Programit të studimit.
3. Mbi bazën e të dhënave që disponon vetë, konform kërkesave të pikës 1/a,b dhe c të nenit 101 të Ligjit 80/2015 dhe elementeve të performancës akademike të studentit, të dëshmuar zyrtarisht nga pedagogu i Modulit, Sekretaria Mësimore, ndërton në exel, procesverbalin e provimit, sipas formatit zyrtar të UV-së, dhe e dërgon atë në *e mail* - in zyrtar të pedagogut.
4. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, pedagogu i Modulit, pasi hedh notat në formatin e procesverbalit të dërguar në *e mail*-in e tij, e printon procesverbalin, e nënshkruan dhe e dorëzon atë në Sekretarinë mësimore. Përpara se ta dorëzojë procesverbalin në SM, emeton në softwerin që është në shërbim të studentëve, vlerësimin për çdo student (notën, M, NP etj, sipas kërkesave të rregulloreve),
5. Procesverbali i printuar nga pedagogu, nënshkruhet nga SM, pasi verifikohen prej saj të dhënat e hedhura paraprakisht që lidhen me kërkesat e pikës 1/a,b dhe c të nenit 101 të Ligjit

80/2015, përmendur më sipër. Pasi nënshkruhet edhe nga Kryesekretaria dhe Dekani, procesverbali i provimit të modulit përkatës, arkivohet dhe ruhet ne SM të departamentit që zhvillon programin e studimit, të cilit i përket ky modul.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Dekanët e Fakulteteve, drejtuesit e njësive bazë, Kryesekretaritë, Sekretaritë Mësimore dhe sektori i IT.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, protokollohet dhe u dergohet të ngarkuarve për zbatim.

DREJTUESI I REKTORATIT

REKTORI

Prof. Dr. Roland Zisi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 1180/1 Prot.

Vlorë, më 09.10.2018

Vendim
Nr. 7, datë 09.10.2018

PËR
MIRATIMIN E PROJEKT- RAPORTIT TE UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI" VLORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 32 si dhe në Udhëzimin Nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të Raportimit vjetor dhe afatit të raportimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë", Rektorati në mbledhjen e datës 09.10.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë projekt- raportin e detajuar të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim të mëtejshëm.

REKTORI
Prof. Dr. Roland Zisi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 1289/1 Prot.

Vlorë, më 30.10.2018

Vendim
Nr. 8, datë 30.10.2018

PËR
RI - MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK 2018- 2024 SIPAS SUGJERIMEVE TE BA
TE UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

Në mbështetje të neni 40 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në sugjerimet e bëra nga ana e Bordit të Administrimit të Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, gjatë mbledhjes së datës 12.10.2018, Rektorati në mbledhjen e datës 09.10.2018

VENDOSI :

1. Të ri- miratojë "Planin Strategjik 2018- 2024" të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim të mëtejshëm.

REKTORI
Prof. Dr/Roland Zasi

